



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 02, datë 13.01.2020

PËR  
MIRATIMIN E RISHIKIMIT TË PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR,  
BASHKIA LUSHNJE

Në mbështetje të neneve 7, 20, 25 dhe 26 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të neneve 11 dhe 12 të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të ndryshuar si dhe të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 4, datë 29.12.2016 të KKT-së “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Lushnje”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Lushnje, si dhe referuar Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 45, datë 24.04.2019, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Lushnje, pjesë e të cilit është dokumenti i mëposhtë:
  - *Dokumenti i Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Lushnje.*
2. Ngarkohen Bashkia Lushnje dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, për botimin e Vendimit dhe dokumentit shoqërues të tij, në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit, si dhe për përditësimin e informacionit GIS dhe platformës e-Harta, sipas ndryshimeve të miratura.
3. Ngarkohen Bashkia Lushnje, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, si dhe autoritetet përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI


EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

  
BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

  
LEDIA TOTA

